



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1702/ 15 Prot.,

Datë 10.10.2025

V E N D I M
Nr. 1428/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2025 shqyrtoi ankesën me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “MURATI D” ShPK dhe nga operatori ekonomik “SOFIA MYFTARI” P.F në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: Materiale Pastrimi me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F, me NIPT L42103023G. Adresa: Rruga “Qelqit”, Z. Kadastrale Nr.3866, Nr. Pasurie 310/20 Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastër
Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokastër.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, me NIPT K42003004T Adresa: “Rruga e Kavajës”, Ish-Kombinati Ushqimor, godinë 1- katëshe, Tiranë.

Operatori ekonomik “SOFIA MYFTARI” P.F, me Nipt K42611766Q, Adresa: Lagja “18 Shtatori”, godinë 1 katëshe, pranë Fakultetit Ekonomik, Gjirokastër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues legjitimohet të paraqisë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 23.05.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: Materiale Pastrimi me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 13.06.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në SPE dhe ka kryer renditjen e tyre si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1- MURATI D SHPK	2,477,573	Kualifikuar
2- SOFIA MYFTARI PF	2.619.025	Kualifikuar
3- ATLANTIK 3 SHPK	2,642,505	Skualifikuar

4- T&J Construction SHPK	2,724,427	Skualifikuar
5- BESIM KAMBERI PF	2,954,485	Kualifikuar
6- MIFEEL SHPK	2,970,005	Skualifikuar
7- F&O COMPANY SHPK	3,082,094	Skualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë **24.06.2025**, ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4 Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5491, datë 29.06.2025 dhe me Nr. 1702/2025 Prot., datë 30.06.2025 e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me objekt: Materiale Pastrimi, Nr. REF-48143-05-19-2025, me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “MURATI D” SHPK dhe nga operatori ekonomik “SOFIA MYFTARI” P.F, në procedurën e sipërcituar.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1702/1 prot., datë 01.07.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Me shkresën, ardhur me shërbim postar, me Nr. 6608 Prot., datë. 07.07.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1702/2, datë 09.07.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë: Vendimin e KSHA-së me Nr. 6608 Prot., datë 07.07.2025 për mospranim të ankesës.

II.7. Me Vendimin Nr. 903/2025, datë 15.07.2025, me objekt Korrigjim Formulari për Publikim, Komisioni konstatoi se në Formularin për Publikim nr. 1702/1 prot., datë 01.07.2025 nuk ishin pasqyruar pretendimet e ankimuesit për operatorin ekonomik Sofia Myftari, P.F. dhe Vendosi mbi korrigjimin e Formularin për Publikim.

II.8. Komisioni i Prokurimit Publik më datë 15.07.2025 publikoi Formularin për Publikim me Nr. 1702/5 prot., mbi pretendimet e ankimuesit **BESIM KAMBERI PF**, për operatorin ekonomik “**MURATI D**” SHPK dhe për operatorin ekonomik “**SOFIA MYFTARI**” P.F, në procedurën e sipërcituar.

II.9. Me shkresën nr. 1702/6 prot., datë 05.08.2025, drejtuar AK-së, Komisioni kërkoi informacion mbi trajtimin e ankesës për pretendimet e ankimuesit për Sofia Myftari P.F, ofertuese në procedurën objekt shqyrtimi.

II.10. Me shkresën, ardhur me shërbim postar, me Nr. 8175/1 Prot., datë. 11.08.2025, protokolluar me tonën me Nr.1702/7, datë 13.08.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë: Vendimin e KSHA-së me Nr. 8175/1 Prot., datë 09.08.2025, për mospranim të pretendimeve të ankesës në lidhje me operatorin ekonomik Sofia Myftari P.F.

II.11. Me shkresën me Nr. 1702/8, datë 04.09.2025, KPP kërkoi dokumentacion dhe mostra si vijon:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “MURATI D” SHPK dhe “SOFIA MYFTARI” P.F në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

Me anë të shkresës me Nr. 6608 Prot., datë. 07.07.2025, protokolluar me tonën me Nr.1702/2, datë 09.07.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë:

Vendimin e KSHA-së me Nr.6608 Prot., datë 07.07.2025 për mospranim të ankesës.

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pretendimeve të ngritura në ankesë, dhe informacionit të AK-së, Komisioni, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës kërkon nga Autoriteti kontraktor si më poshtë:

1. Dokumentacionin provues të ofertës së operatorit ekonomik “MURATI D” SHPK.

2. Mostrat e dorëzuar pranë AK nga operatorët ekonomikë “MURATI D” SHPK dhe “SOFIA MYFTARI” P.F për të cilat ngrihen pretendime e konkretisht

Mostrat dorëzuar nga “MURATI D” SHPK për artikujt objekt ankimi :

Art. 1. Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)

Art. 14. Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg

Art. 35. Klor pluhur dezinfektues 56% CL

Art. 42. Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër.

Art. 44. Letër higjenike e bardhë (Paketimi: 10 roll,100% celuloze 3 fletësh, pesha 750 gr)

Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800 gr).

Mostrat dorëzuar nga SOFIA MYFTARI P.F për artikujt objekt ankimi:

Art. 1. Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)

Art. 14. Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg

Art. 35. Klor pluhur dezinfektues 56% CL

Art. 42. Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër.

Art. 44. Letër higjenike e bardhë (Paketimi: 10 roll,100% celuloze 3 fletësh,pesha 750 gr)

Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800 gr).

Sa më sipër, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë informacionin e kërkuar, mostrat për të cilat ankimuesi ngre pretendime së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre si edhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, dokumentacionin e plotë mbi konstatimin dhe vlerësimin e tyre.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijëni e kësaj shkrese.

II.12. Autoriteti Kontraktor me shkresën përcjellë pranë KPP-së me Nr. 9028 Prot., datë 04.09.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1702/9, datë 08.09.2025, me objekt “Kërkesë për Vendimmarrje”.

II.13. Me shkresën më Nr. 9149/1 prot., datë 11.09.2025, me objekt “Informacion dhe mostra”, protokolluar me tonën me Nr. 1702/10, datë 12.09.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë si vijon:

1. Shkresë dorëzimi mostrash “Murati D” SHPK me nr. 5049 prot, datë 02.06.2025.

2. Shkresë dorëzimi mostrash “Sofia Myftari” P.F me nr. 5050 prot, datë 02.06.2025

3. Procesverbal i dorëzimit të mostrave me nr.5057, datë 02.06.2025.

4. Formulari i ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” SHPK.

Mostra të dorëzuara nga OE “MURATI D” SHPK dhe “SOFIA MYFTARI” P.F.

II.14. Me shkresën më Nr. 1702/11 prot., datë 22.09.2025, me objekt “Kërkesë për dërgim dokumentacioni”, Komisioni përsëriti kërkesën për: [...] *Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”* Autoriteti Kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, kopje të njësuara me origjinalin të dokumentacionit të plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “MURATI D” SHPK. [...]

II.15. Me shkresën më Nr. 9809/1 prot., datë 24.09.2025, me objekt “Informacion”, protokolluar me tonën me Nr. 1702/12, datë 26.09.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së Dokumentacion provues të ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” ShPK, 285 fletë.

II.16. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nuk ka pretendime nga operatorë të tjerë të interesuar për këtë procedurë prokurimi objekt shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi operatorin ekonomik “Sofia Myftari” P.F. me argumente si vijon: “Në DST, autoriteti kontraktor ka kërkuar pikën 2.6 operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

2.6 Operatoret Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nr	Emërtimi i Artikujve
1	Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)
6	Aparat për aromë ambienti
14	Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg
35	Klor pluhur dezinfektues 56% CL
36	Klor xhel 1 litër
42	Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër
44	Letër higjienike e bardhë (Paketimi:10 roll, 100% celulozë 3 fletësh, pesha 750 gr)
45	Letër rolo për duar me prerje,ngjyre e bardhë (800gr)
62	Solucion për larje mobiljesh

Persa i përket mostrës për **art.1** Ky operator ekonomik ka dorëzuar mostrën në mospërputhje të plotë pasi paketimi i këtij produkti **nuk është 75 ml por është 1 L**, e cila dallohet lehtësisht diferenca kriter-mostër në ambalazhin e produktit. Sipas preventivit të ak kemi të bëjmë me 2 produkte mbi të cilat.–

Referuar zërit me numrin rendor 14 Detergjent rrobash per lajre me dore 3 kg ky OE ka dorëzuar mostër për detergjent rrobash për larje automatike (lavatriçe), çka është shumë e ndryshme nga produkti i kërkuar nga AK. Diferenca e tyre qëndron në faktin se elementët kimik përbërës të këtyre produkteve janë të ndryshme pasi për produktin detergjent rrobash për larje me dorë element kryesor është ruajtja e lëkurës dhe detergjenti për larje me lavatriçe nuk mund të përdoret për larje me dorë pasi krijon probleme të parikuperueshme në lëkurë dhe është i rrezikshëm.

Kjo vendos operatorët ekonomikë në kushte pabarazie duke ndikuar drejtpërdrejtë në ofertim si dhe në renditje. Mangësitë e përmendura më lartë janë thelbësore të cilat ishin shumë të thjeshta për tu verifikuar dhe përbëjnë shkak për skualifikim.

Referuar zërit me numrin rendor 35 Klor pluhur dezinfektues 56% CL ky OE ka dorëzuar mostrën klor pluhur dezinfektues por **jo me masën 56% cl** të kërkuar nga AK. Kërkojmë nga KSHA verifikimin e saj pasi është lehtësisht e dukshme në ambalazhin e produktit dhe përsakohë është e përcaktuar në specifikimet teknike, nuk mund të anashkalohet si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie dhe **theksojmë se diferenca në % e cl përkthehet në çmim të ofertuar.**

- **Referuar zërit me numrin rendor 42 Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër** ky OE ka dorëzuar mostër me **përmasa të ndryshme nga 32x32**, të cilën nuk e ka të shënuar në etiketë dhe përbën një zë të specifikimit teknik të pavërtetueshëm se me çfarë përmasash janë. **Gjithashtu mostra e dorëzuar është mikrofibër për pastrim pluhurash dhe jo për larje xhamash, element ky që verifikohet në ambalazhin e produktit.**

Kërkojmë nga KSHA verifikimin e saj pasi është lehtësisht e dukshme në ambalazhin e produktit dhe përsakohë është e përcaktuar në specifikimet teknike, nuk mund të anashkalohet si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie pasi çmimi i produktit të kërkuar nga ak është shumë më i shtrenjtë sesa mostra e dorëzuar nga ak. Edhe në këtë rast janë 2 produkte të ndryshme të cilat nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, kanë funksione dhe çmime të ndryshme.

-Referuar zërit me numrin rendor 44-Letër higjenike e bardhë (Paketimi: 10 roll, 100% celulozë 3 fletësh, pesha 750gr) ky OE ka dorëzuar mostrën në mospërputhje me specifikimet teknike pasi nuk shënohet dhe nuk është provuar pesha e saj 750 gr kërkuar nga ak. Nuk mund të anashkalohej si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie, theksojmë se pesha e këtij produkti ndikon drejtpërdrejtë në çmimin e ofertuar. Dhe kjo mospërputhje përbën shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik.

-Referuar zërit me numrin rendor 45 Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800gr) ky OE ka dorëzuar mostrën në mospërputhje me specifikimet teknike pasi nuk shënohet dhe nuk është provuar pesha e saj 800 gr kërkuar nga ak.

Nuk mund të anashkalohej si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie, theksojmë se pesha e këtij produkti ndikon drejtpërdrejtë në çmimin e ofertuar. Dhe kjo mospërputhje përbën shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik.

III.1.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 8, Kriteria të Veçanta për Kualifikim, 2.3 Kapaciteti teknik: Kriterin 2.6 Operoret Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nr	Emërtimi i Artikujve
1	Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)
6	Aparat për aromë ambienti
14	Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg
35	Klor pluhur dezinfektues 56% CL
36	Klor xhel 1 litër
42	Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër
44	Letër higjenike e bardhë (Paketimi: 10 roll,100% celuloze 3 fletësh, pesha 750gr)
45	Letër rolo për duar me prerje,ngjyre e bardhë (800gr)
62	Solucion për larje mobiljesh

- *Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të përcaktuar në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll - Arkiv pranë Bashkisë Gjirokastrë.*
- *Për paraqitjen e mostrave do të mbahet procesverbal për të administruar procesin e dorëzimit midis Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Operator-it/ eve Ekonomik.*
- *Ky kriter i shërben AK për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara me qëllim që cilësia të jetë në përputhje me kërkeat për prokurim.*
- *Mostrat do të jenë me etiketë të ngjitur e cila tregon "emërtimin e artikullit" numrin rendor sipas preventivit të ngarkuar dhe ofertës së tyre, emrin e ofertuesit dhe vulën e operatorit ekonomik.*
- *Mostrat e paraqitura do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të AK*
- **Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.**
- *Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike përbën kusht për skualifikim.*
- *Operatori ekonomik fitues do të dorëzojë mallin pas lidhjes së kontratës të njëjta me mostrat e dorëzuara në të kundërt përbën kusht për zgjidhje kontrate.*

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën me Nr.1702/8, datë 04.09.2025, KPP kërkoi dokumentacion dhe mostra të OE “Sofia Myftari” P.F si vijon:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “MURATI D” SHPK dhe “Sofia Myftari” P.F në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

2. Mostrat e dorëzuar pranë AK nga operatorët ekonomikë “MURATI D” SHPK dhe “SOFIA MYFTARI” P.F për të cilat ngrihen pretendime e konkretisht Mostrat dorëzuar nga SOFIA MYFTARI P.F për artikujt objekt ankimi:

Art. 1. Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)

Art. 14. Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg

Art. 35. Klor pluhur dezinfektues 56% CL

Art. 42. Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibrë.

Art. 44. Letër higjienike e bardhë (Paketimi: 10 roll,100% celuloze 3 fletësh,pesha 750gr)

Art. 45. Letër rolo për duar me prerje,ngjyre e bardhrë (800gr).

Sa më sipër, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë informacionin e kërkuar, mostrat për të cilat ankimuesi ngre pretendime së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre si edhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, dokumentacionin e plotë mbi konstatimin dhe vlerësimin e tyre.

III.1.4. Autoriteti Kontraktor me shkresën më Nr. 9149/1 prot., datë 11.09.2025, me objekt “Informacion dhe mostra”, protokolluar me tonën me Nr. 1702/10, dt 12.09.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë si vijon:

Shkresë dorëzimi mostrash “Sofia Myftari” P.F me nr. 5050 prot, datë 02.06.2025;

Proces-verbal i dorëzimit të mostrave me nr.5057, datë 02.06.2025;

Mostra të dorëzuara nga OE “Sofia Myftari” P.F.

III.1.5. Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.6. Nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkohet shprehimisht:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.7 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me dokumentet e tenderit përsa kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato, dhe mospërmbushja qoftë edhe e një kriteri apo specifikimi teknik përbën shkak skualifikimi nga autoriteti kontraktor.

III.1.8. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, rezulton se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar në tabelën përkatëse, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të përcaktuara në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll- Arkiv pranë Bashkisë Gjirokastrë.

Nisur nga pretendimet e ankimesit si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i

mostrave të dorëzuara nga AK rezulton se, Operatori ekonomik “Sofia Myftari” P.F ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Për Art.1 Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik), operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se solucioni është

Acid Muriati për pastrim WC, në Paketimi 1 Litër, për tualet,

-Përsa konstatuar produktit mostër për art.1 përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës objekt ankimi, pesha 1 litër nuk ndikon në cilësinë e produktit.

Për Art. 14. Detergjent rrobash për larje me dore 3 kg operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se detergjenti është me emërtimin:

Washing detergjent 3 kg, ku referuar të dhënave detergjenti përdoret për larje nga 20° deri në 90°, si në lavatriçe edhe për larje të rrobave me dorë.

-Përsa konstatuar produkti mostër për art.14 përmbush specifikimet teknike përsa i përket qëllimit të përdorjes,

Për Art. 35. Klor pluhur dezinfektues 56% CL, operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet,

Paketim më qese të tejdukshme brenda të cilit ka pluhur në formë kokrrize të bardhë dhe në etiketë shënuar përberja 56% CL

-Përsa konstatuar produkti mostër për art 35, në paketimin e tij ka etiketë mbi të dhëna për emërtimin e produktit dhe përqindjen e përbërjes kimike .

Për Art. 42. Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër. Operatori ekonomik ka dorëzuar mostër:

Lecka Microfibra në paketim ka të dhëna për përbërjen: 80% poliester dhe 20% poliamid, thithin pluhurat dhe nuk dëmtojnë sipërfaqet.me përmasa 31x35 cm. Nga foto në etiketë konstatohet se përdoren për pastrim të sipërfaqeve në përbërje druri dhe xhami.

-Përsa konstatuar artikulli mostër përmbush specifikimet teknike.

Për Art. 44. Letër higjenike e bardhë (Paketimi: 10 roll,100% celulozë 3 fletësh, pesha 750 gr), operatori ekonomik ka dorëzuar mostër:

Letër higjenike e bardhë, paketim me 10 role, pesha 370gr +3%.

-Përsa konstatuar produkti mostër për art.44 nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës së kërkuar.

Për Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyre e bardhë (800gr). Operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se,

Letër kuzhine Rolo për duart, e bardhë, pesha 450 gr +5%,

-Përsa konstatuar produkti mostër për art.45 nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës së kërkuar.

Komisioni thekson faktin se qëllimi i AK për paraqitje të mostrave është nëse ato përmbushin specifikimet teknike me të dhënat që përmbajnë artikujt objekt prokurimi në tërësi dhe ato të kërkuara për mostra në veçanti, në përputhje me nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre sipas kërkesave dhe kritereve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato.

Operatori ekonomik ankimues nuk ka përmbushur kërkesat minimale siç janë përputhja e të dhënave të kërkuara në DST për artikujt që do të ofertojë, ndaj dhe të dhënat që përmbajnë artikujt paraqitur si mostra nga operatori “Sofia Myftari” P.F. duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.

Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me Dokumentet e tenderit dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Në përfundim të konstatimit të fakteve Komisioni gjykon se operatorin ekonomik “Sofia Myftari” P.F nuk plotëson kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike në këtë procedurë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ankimuesit për operatorin ekonomik “Sofia Myftari” P.F, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.1.8 rezulton se ky operator nuk përmbush specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim, ndaj dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Sofia Myftari” P.F do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit, objekt shqyrtimi, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit “Besim Kamberi” P.F.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik në lidhje me dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” ShPK me argumente si vijon:

“Në dokumentet standarde të tenderit, AK ka kërkuar operatorin ekonomik pjesëmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave të kodeve buxhetore përkatëse në preventiv në të kundërt përben kusht për skualifikim, duke përcaktuar dhe fondin limit përkatës për çdo kod buxhetor.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave të kodeve buxhetore përkatëse në preventiv në të kundërt përben kusht për skualifikim.

KUJDES

V111AAD	750,000.00
V822AAC	124,990.00
V823AAB	200,000.00
V328AAC	83,315.00
V510AAC	227,500.00
V510AAD	605,000.00
V912AAB	375,000.00
V923AAB	750,000.00
V923AAD	125,00.00
V424AAE	41,660.00

Në ofertën e tij ky operator ekonomik pavarësisht se në vlerën totale nuk e ka tejkaluar fondin limit ka tejkaluar fondin limit sa i takon kodeve të mësipërme duke e bërë ofertën e pavlefshme. Gjithashtu nuk është sipas formatit të kërkuar në ligj sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3 për ndarjen e kodeve buxhetore. Pra oferta është e pavlefshme si në formë ashtu edhe në përmbajtjen e saj dhe si e tillë AK do të duhej ta skualifikonte këtë operator ekonomik.

III.3.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcat në DST, **Shtojcat** në lidhje me ofertën ekonomike si vijon: **Shtojca 1.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Vula	
Datë	

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe të vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë					

Shtojca 8, 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.6 paragrafi i fundit

KUJDES

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave të kodeve buxhetore përkatëse në preventiv, në të kundërt përbën kusht për skualifikim.

KUJDES

V111AAD	750,000.00
V822AAC	124,990.00
V823AAB	200,000.00
V328AAC	83,315.00
V510AAC	227,500.00
V510AAD	605,000.00
V912AAB	375,000.00
V923AAB	750,000.00
V923AAD	125,00.00
V424AAE	41,660.00

III.3.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se, operatori ekonomik “Murati D” SHPK ka dorëzuar si pjesë të ofertës:

Shtojca 1 Formularin e ofertës ekonomike të plotësuar me vlerën totale (pa tvsh dhe me tvsh) të ofertës ekonomike të firmosur dhe vulosur, si edhe

Shtojca 2, Lista e Çmimeve të Artikujve, plotësuar tabela përkatëse me të gjithë artikujt në total, firmosur dhe vulosur në dy faqe nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik.

Shtojca 1 dhe shtojca 2 përkatësisht sipas kodeve si vijon:

Për kodin buxhetor V 111AAD Aparati, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 912AAB Arsimi bazë, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 923AAB Parauniversitar, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 923AAD Konvikte, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 510AAD Komunale, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 510AAC Komunale 2, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 328AAC MZHZ, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 822AAC Kultura, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 823AAC Turizmi, me artikujt, me çmime dhe vlera.

Për kodin buxhetor V 424AAE Bulqësia, me artikujt, me çmime dhe vlera.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.4. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kërkesave për t’u plotësuar nga ofertuesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e vendosura.

Në plotësimin e dokumentacionit të ofertës, operatorët ekonomikë duhet t’i përmbahen me rigorozitet dokumenteve të publikuara në DST, duke plotësuar të gjitha dokumentet siç ato janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor si dhe të detyrueshme për t’u plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në procedurat e prokurimit.

Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit: [...] Në ofertën e tij ky operator ekonomik pavarësisht se në vlerën totale nuk e ka tejkaluar fondin limit ka tejkaluar fondin limit sa i takon kodeve të mësipërme duke e bërë ofertën e pavlefshme. Gjithashtu nuk është sipas formatit të kërkuar në ligj sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3 për ndarjen e kodeve buxhetore. Pra oferta është e pavlefshme si në formë ashtu edhe në përmbajtjen e saj dhe si e tillë AK do të duhej ta skualifikonte këtë operator ekonomik., [...], Komisioni kreu verifikimet mbi dokumentacionin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, nga operatori ekonomik “Murati D” ShPK, nga ku konstatohet se operatori ka dorëzuar si pjesë të ofertës së tij ekonomike:

Shtojca 1 Formularin e ofertës ekonomike të plotësuar të firmosur dhe vulosur, si edhe **Shtojca 2, Lista e Çmimeve të Artikujve**, plotësuar tabela me emërtimet e të gjithë artikujve, sipas Kodeve buxhetore përkatës duke listuar artikujt me sasi të kërkuara, çmimet për njësi dhe vlerat pa tvsh dhe me tvsh.

Përsa konstatuar dokumentacioni sipërcituar (Pika III.3.2) rezulton i plotë i firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik.

Komisioni referuar ankesës konstaton se, operatori ekonomik ankimues nuk ka argumentuar qartë mangësi konkrete të ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Murati D” ShPK, duke ngritur pretendime apriori pa prova dhe fakte mbi dokumentet e operatorit ekonomik.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, referuar dokumentacionit të tenderit si edhe ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK në SPE, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e ofertës ekonomike në përputhje me DST.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit “Besim Kamberi” P.F mbi mospërmbushje nga operatori ekonomik “Murati D” ShPK të kriterit:

2.6, Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nr	Emërtimi i Artikujve
1	Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)
6	Aparat për aromë ambienti
14	Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg
35	Klor pluhur dezinfektues 56% CL
36	Klor xhel 1 litër
42	Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibrë
44	Letër higjienike e bardhë (Paketimi: 10 roll, 100% celuloze 3 fletësh, pesha 750 gr)
45	Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800gr)
62	Solucion për larje mobiljesh

Referuar zërit me nr. 1 Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik) dorëzuar mostrën për art 1, produkti nuk është 75 ml por është 1 l, e cila dallohet lehtësisht diferenca kriter-mostër në ambalazhin e produktit.

Sipas preventivit të AK kemi të bëjmë me 2 produkte mbi të cilat është përshkruar sasia e caktuar si dhe specifikimet për secilën.

Produkti 1 Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% si dhe

Produkti 2 Acid pastrimi për WC (Paketim 1 l, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik), ku për produktin 1 sasia totale është 300 copë kurse për produktin 2 sasia totale është 395 copë.

Ky operator ekonomik ka dorëzuar mostrën për numrin rendor 2 dhe jo 1 duke mospërmbushur një nga kriteret i cili përbën shkak për skualifikim. Duke e njohur tregun theksojmë se produkti 1 është i vështirë për t’u gjendur në treg dhe kur nuk dorëzohet si mostër nga operatorët ekonomik tregon që nuk e disponojnë por në kundërshtim me kriteret, ofertën dhe preventivin...

Referuar zërit me numrin rendor 14 detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg, ky operator ka dorëzuar mostër për detergjent rrobash për larje automatike (lavatriçe), çka është shumë e ndryshme nga produkti i kërkuar nga ak. Specifikime teknike të cilat janë shumë të lehta për t’u krahasuar mbi bazën e ambalazhit të produktit. Diferenca e tyre qëndron në faktin se elementët kimik përbërës të këtyre produkteve janë të ndryshme, pasi për produktin detergjent rrobash për larje me dorë element kryesor është ruajtja e lëkurës

dhe detergjenti për larje me lavatrice nuk mund të përdoret për larje me dorë pasi krijon probleme të parikuperueshme në lëkurë dhe është i rrezikshëm.

Lidhur me këtë produkt operatori fitues Murati D, ka kërkuar dhe sqarim në SPE ku shkruan “ju lutemi më bëni të qartë në lidhje me ambalazhimin e detergjentit të rrobave për larje me dorë përkatësisht nr. 14 aty thuhet: detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg” me njësi përkatësisht copë. Ju bëjmë me dije se ambalazhimi i detergjentit të rrobave me dorë është me ambalazhim 600 gr dhe asnjëherë nuk ka qenë 3 kg.

Prandaj kërkojmë një sqarim që ndoshta është bërë një lapsus në njësi.

Referuar zërit me numrin rendor 35 Klor pluhur dezinfektues 56% cl. Ky OE ka dorëzuar mostrën klor pluhur dezinfektues por jo me masën 56% cl të kërkuar nga ak. Kërkojmë nga KSHA verifikimin e saj pasi është lehtësisht e dukshme në ambalazhin e produktit dhe përsakohë është e përcaktuar në specifikimet teknike, nuk mund të anashkalohe si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie dhe theksojmë se diferenca në % e cl përkthehet në çmim të ofertuar.

-Referuar zërit me numrin rendor 42 Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër ky OE ka dorëzuar mostër me përmasa të ndryshme nga 32x32, të cilën nuk e ka të shënuar në etiketë dhe përbën një zë të specifikimit teknik të pavërtetueshëm se me çfarë përmasash janë. Gjithashtu mostra e dorëzuar është mikrofibër për pastrim pluhërash dhe jo për larje xhamash, element ky që verifikohet në ambalazhin e produktit. Kërkojmë nga KSHA verifikimin e saj pasi është lehtësisht e dukshme në ambalazhin e produktit dhe përsakohë është e përcaktuar në specifikimet teknike, nuk mund të anashkalohe si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie, pasi çmimi i produktit të kërkuar nga ak është shumë më i shtrenjtë sesa mostra e dorëzuar nga ak. Edhe në këtë rast janë 2 produkte të ndryshme të cilat nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, kanë funksione dhe çmime të ndryshme.

-Referuar zërit me numrin rendor 44 Letër higjienike e bardhë (paketimi: 10 roll, 100% celulozë 3 fletësh, pesha 750gr) ky OE ka dorëzuar mostrën në mospërputhje me specifikimet teknike pasi nuk shënohet dhe nuk është provuar pesha e saj 750 gr, Nuk mund të anashkalohe si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie, theksojmë se pesha e këtij produkti ndikon drejtpërdrejtë në çmimin e ofertuar. Dhe kjo mospërputhje përbën shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik.

-Referuar zërit me numrin rendor 45 Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800gr) ky OE ka dorëzuar mostrën në mospërputhje me specifikimet teknike pasi nuk shënohet dhe nuk është provuar pesha e saj 800 gr kërkuar nga AK. Nuk mund të anashkalohe si element i parëndësishëm pasi përbën shkelje duke vendosur operatorët e tjerë në kushte pabarazie, theksojmë se pesha e këtij produkti ndikon drejtpërdrejtë në çmimin e ofertuar.

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 8, Kriteria të Veçanta për Kualifikim, 2.3 **Kapaciteti teknik: Kriterin 2.6** Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nr	Emërtimi i Artikujve
1	Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik)

6	Aparat për aromë ambienti
14	Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg
35	Klor pluhur dezinfektues 56% CL
36	Klor xhel 1 litër
42	Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër
44	Letër higjienike e bardhë (Paketimi: 10 roll, 100% celulozë 3 fletësh, pesha 750 gr
45	Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800gr)
62	Solucion për larje mobiljesh

- *Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të percaktuar në dokumentat e tenderit pranë zyrës së Protokoll - Arkiv pranë Bashkisë Gjirokastër.*
- *Për paraqitjen e mostrave do të mbahet procesverbal për të administruar procesin e dorëzimit midis Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Operator-it/ eve Ekonomik.*
- *Ky kriter i shërben AK për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara me qëllim që cilësia të jetë në përputhje me kërkesat për prokurim.*
- *Mostrat do të jenë me etiketë të ngjitur e cila tregon "emërtimin e artikullit", numrin rendor sipas preventivit të ngarkuar dhe ofertës së tyre, emrin e ofertuesit dhe vulën e operatorit ekonomik.*
- *Mostrat e paraqitura do të trajtohen si informacion konfidencial tregëtar dhe do të jenë në kontroll të AK.*
- **Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.**
- *Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike përbën kusht për skualifikim.*
- *Operatori ekonomik fitues do të dorëzojë mallin pas lidhjes së kontratës të njëjta me mostrat e dorëzuara në të kundërt përbën kusht për zgjidhje kontrate.*

III.4.2 Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën me Nr.1702/8, datë 04.09.2025, kërkoi dokumentacion dhe mostra të OE "MURATI D" SHPK si vijon:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga "MURATI D" SHPK dhe "SOFIA MYFTARI" P.F në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

Mostrat e dorëzuar pranë AK nga operatorët ekonomikë "MURATI D" SHPK dhe "SOFIA MYFTARI" P.F për të cilat ngrihen pretendime e konkretisht:

Mostrat dorëzuar nga "MURATI D" SHPK për artikujt objekt ankimi:

Art. 1. Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik);

Art. 14. Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg;

Art. 35. Klor pluhur dezinfektues 56% CL;

Art. 42. Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër;

Art. 44. Letër higjienike e bardhë (Paketimi: 10 roll, 100% celulozë 3 fletësh, pesha 750gr);

Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyrë e bardhë (800gr).

Sa më sipër, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë informacionin e kërkuar, mostrat për të cilat ankimuesi ngre pretendime së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre si edhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, dokumentacionin e plotë mbi konstatimin dhe vlerësimin e tyre.

III.4.3. Autoriteti Kontraktor me shkresën me Nr. 9149/1 prot., datë 11.09.2025, me objekt “Informacion dhe mostra”, protokolluar me tonën me Nr. 1702/10, datë 12.09.2025, ka përcjellë si vijon:

Shkresë dorëzimi mostrash “MURATI D” SHPK me nr. 5050 prot, datë 02.06.2025;

Procesverbal i dorëzimit të mostrave me nr.5057, datë 02.06.2025;

Mostra të dorëzuara nga OE “MURATI D” SHPK”.

III.4.4.Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.5. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkohe shprehimisht:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

III.4.6 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për

Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me dokumentet e tenderit përse kohë i kanë pranuar ato dhe, mospërmbushja qoftë edhe e një kriteri apo specifikimi teknik përbën shkak skualifikimi nga autoriteti kontraktor.

III.4.7. Komisioni, referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, vëren se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall, të kërkuar në tabelën përkatëse, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të përcaktuar në dokumentet e tenderit pranë zyrës së Protokoll- Arkiv pranë Bashkisë Gjirokastër.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se mostrat e dorëzuara nga AK pranë Komisionit rezultojnë si më poshtë vijon:

Për Art.1 Acid pastrimi për WC (Paketim 75 ml, për tualet, i fortë, 21% klorhidrik), operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se solucioni është **Acid Klorhidrik 21%, për pastrim WC, në Paketimi 0.75 Litër, për tualet,**

-Përse konstatuar produkti mostër për art.1 përmbush specifikimet teknike përse i përket përbërjes kimike të solucionit dhe peshës.

Për Art. 14. Detergjent rrobash për larje me dorë 3 kg, operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se detergjenti është me emërtimin:

Detergjent 3 kg, për rroba të bardha dhe me ngjyra ku referuar të dhënave detergjenti përdoret për larje në lavatriçe në temperatura nga 30° deri 60° C dhe programe të ndryshme larjeje si edhe përdoret për larje të rrobave me dorë.

-Përse konstatuar produkti mostër për art.14 përmbush specifikimet teknike përse i përket qëllimit të përdorjes.

Për Art. 35. Klor pluhur dezinfektues 56% CL, operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet,

Paketim me qese të tejdukshme brenda të cilit ka pluhur në formë kokrrize të bardhë me etiketë me specifikimet teknike.

-Përse konstatuar produkti mostër për art 35, në paketimin e tij ka etiketë mbi të dhënat për emërtimin e produktit dhe përqindjen e përbërjes kimike.

Për Art. 42. Lecka për larje xhamash 32x32 mikrofibër, operatori ekonomik ka dorëzuar mostër:

Lecka Mikrofibër për pastrim të përgjithshëm me përmasa 35x35 cm. Nga foto në etiketë konstatohet se përdoren për pastrim të sipërfaqeve të ndryshme.

-Përsa konstatuar artikulli mostër per art. 42 përmbush specifikimet teknike.

Për Art. 44. Letër higjenike e bardhë (Paketimi: 10 roll,100% celuloze 3 fletësh, pesha 750gr), operatori ekonomik ka dorëzuar mostër:

Letër higjenik e bardhë, paketim me 10 role, celuloze, 3 shtresa, toleranca $\pm 5\%$, nga përmasat e dhëna në paketim, pesha 48gr/m² x18m² 864 gr

-Përsa konstatuar produkti mostër për art.44 përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës.

Për Art. 45. Letër rolo për duar me prerje, ngjyre e bardhë (800gr), operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se,

Letër kuzhine Soft, e bardhë, pesha 800gr, 100% celulozë,

-Përsa konstatuar produkti mostër për art.45, përmbush specifikimet teknike përsa i përket peshës.

Përsa më sipër Komisioni thekson faktin se qëllimi i AK-së për paraqitje të mostrave është nëse ato përmbushin specifikimet teknike me të dhënat që përmbajnë artikujt objekt prokurimi në tërësi dhe ato të kërkuara për mostra në veçanti, në përputhje me nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre sipas kërkesave dhe kritereve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato, duke qenë detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me mallra që oferton përputhjen me specifikimet dhe kërkesat e autoritetit kontraktor pasi në të kundërt duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni, nga verifikimet e kryera të mostrave objekt ankimi, të dorëzuar nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK, konstatoi se mostrat përmbushin specifikimet teknike siç janë të kërkuara në DST, duke përmbushur gjithashtu kriterin kualifikues 2.6.

Në përfundim të konstatimit të fakteve Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Murati D” SHPK plotëson kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike në këtë procedurë.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë .

III.5. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik BESIM KAMBERI PF, me anë të së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertës për “MURATI D” SHPK, e konkretisht argumentuar si vijon: [...] 1. Si operator i shpallur fitues ka patur detyrimin ligjor për të dorëzuar dokumentacion provues lidhur me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sa i takon pikave a, b, d, dh, e, h, i dhe j.

Këtij operatori ekonomik i mungon dokumentacioni provues lidhur me pika b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të

nenit 76, të LPP-së; këtij operatori ekonomik i **mungon dokumentacioni provues lidhur me pika**

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose Ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është Ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; këtij operatori ekonomik i **mungon dokumentacioni provues lidhur me pika**

e) operatori ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e republikës së Shqipërisë.

III.5.1. Nga shqyrtimi pretendimeve të ngritura në ankesën e sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi AK-së të dorëzojë kopje të dokumentacionit të plotë, të dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Murati D ” SHPK, i renditur i pari.

III.5.1. Me shkresën Nr.9809/1 prot., datë 24.09.2025, “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr. 1702/12, datë 26.09.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë dokumentet provuese të ofertës së operatorit ekonomik “Murati D” SHPK, total 289 fletë, kopje të njehsuara me origjinalin.

III.5.2 Autoriteti kontraktor ka publikuar Dokumentet Standarde të Tenderit në SPE, pjesa objekt ankimi, e Shtojca 9, FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj.

<p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

III.5.3 Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.4 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.5.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti

kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.5.6. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.5.7. Operatori ekonomik “Murati D” SHPK, ka depozituar në SPE: Dokumentin emërtuar: Shtojca_9, në brendi të të cilit gjendet, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i plotësuar, Dokumentacionin e ofertës ekonomike, teknike dhe dokumente faktesh.

Në referim të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimuesit, Komisioni mori në shqyrtim dokumentin Shtojca 9, të operatorit ekonomik “Murati D” SHPK pjesë të ofertës së tij në SPE dhe konstatoi se, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit rezultoi i plotësuar në të gjitha pjesët dhe Seksionet e tij, i firmosur dhe vulosur, gjithashtu Komisioni mori në shqyrtim dokumentacionin e ofertës në DST dhe dokumentacionin provues të operatorit ekonomik “Murati D” SHPK dhe konstatoi, se operatori ekonomik ka plotësuar me të dhëna të plota përsa i përket pretendimeve për mungesë dokumentacioni provues lidhur me pikat:

pika b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; këtij operatori ekonomik i mungon dokumentacioni provues;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Komisioni konstatoi se në dokumentet provuese të operatorit ekonomik “Murati D” SHPK ka bashkëlidhur dokumentet, objekt ankimi si vijon:

-Vërtetim Nr. 20, datë 27.05.2025, nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, për shtetasin Dervish Murati, administrator dhe ortak i operatorit ekonomik “Murati D” SHPK, rezulton i Pa Dënuar.

-Vërtetimin Nr. 11 prot, datë 22.05.2025, nga Drejtoria Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i gjendjes Gjyqësore, për Subjektin “Murati D” SHPK, rezulton i Pa Dënuar.

-Vërtetim Debie për operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit. Lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE Group, datë 23.05.2025.

[...] Nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit , për kontratën e përdoruesit “Murati D” SHPK, rezulton të ketë 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, deri më 25.05.2025. Dokument i firmosur dhe vulosur nga Administratori i OSHE Group SHA.[..]

Gjithashtu Komisioni verifikoi dokumentet provuese në tërësi të ofertës së ngarkuar në SPE të operatorit ekonomik “Murati D” SHPK, dhe konstatoi se dokumentacioni provues është i plotë i saktë, në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka ngritur pretendime apriori ndaj dhe ankesa e tij ngrihet mbi argumente të pa bazuara dhe të hamendësuar.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F në lidhje me pretendimet për operatorin ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: “Materiale Pastrimi” me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F në lidhje me pretendimet për operatorin ekonomik “Sofia Myftari” P.F në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: “Materiale Pastrimi” me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.
3. Autoriteti kontraktor të kthejë për rivlerësim procedurën e prokurimit në lidhje me vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sofia Myftari” P.F.
4. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi vlerësimin operatorit ekonomik “Sofia Myftati” P.F duke e skualifikuar atë.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

